



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

**V E N D I M**

**PËR MIRATIMIN E VËZHguesVE AFATSHKURTËR TË KOMISIONIT SHTETËROR  
TË ZGJEDHJEVE TË REPUBLIKËS TË MAqedonisË SË VERIUT, PËR VËZHgIMIN  
E ZGJEDHJEVE PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS  
30 QERSHOR, 2019**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e datës 21.06.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI	Kryetar
Denar	BIBA	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI	Anëtar
Edlira	JORGAQI	Anëtare
Rezarta	BITRI	Anëtare

**OBJEKT:** Miratimi i vëzhguesve afatshkurtër të paraqitur nga Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve të Republikës të Maqedonisë së Veriut, për vëzhgimin e zgjedhjeve për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 30 qershor 2019.

**BAZA LIGJORE:** Neni 23, pika 1, gërma "a", neni 6, pika 2, 4, 5, të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar dhe Udhëzimi nr. 13, datë 22.04.2009 "Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja dhe mediave"

**V Ë R E N**

Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve të Republikës të Maqedonisë së Veriut është organ i përhershëm, i pavarur i cili merret me administrimin e zgjedhjeve.



**Nr.843 i Vendimit**

**Data 21.06.2019 Ora 10 .<sup>00</sup> e Vendimit**

Për miratimin e vëzhguesve afatshkurtër të Komisioni Shtetëror të Zgjedhjeve të Republikës të Maqedonisë së Veriut për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor, 2019

Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve të Republikës të Maqedonisë së Veriut ka paraqitur kërkesën e tij bashkë me dokumentacionin mbështetës pranë KQZ-së për akreditimin e 3 (tre) vëzhguesve afatshkurtër. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve vëren se ai është brenda kushteve dhe kërkesave të parashikuara nga Kodi Zgjedhor.

### **PËR KËTO ARSYE**

Bazuar në nenin 23, pika 1, gërma "a", neni 6 , pika 2, 4,5 të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar dhe Udhëzimit nr.13, datë 22.04.2009 "Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare përfaqësues të shteteve të huaja dhe mediave", Komisioni Qendror i Zgjedhjeve:

### **V E N D O S I :**

1. Të miratojë kërkesën e Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve të Republikës të Maqedonisë së Veriut për akreditimin e 3 (tre) vëzhguesve afatshkurtër për vëzhgimin e procesit zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 Qershor 2019, sipas listës të përcaktuar në lidhjen Nr.2 bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

<b>Klement</b>	<b>ZGURI -</b>	<b>Kryetar</b>
<b>Denar</b>	<b>BIBA -</b>	<b>Zv/kryetar</b>
<b>Bledar</b>	<b>SKËNDERI-</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Edlira</b>	<b>JORGAQI-</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Rezarta</b>	<b>BITRI</b>	<b>Anëtare</b>



**Nr.843 i Vendimit**

**Data 21.06.2019 Ora 10 .<sup>00</sup> e Vendimit**

Për miratimin e vëzhguesve afatshkurtër të Komisioni Shtetëror të Zgjedhjeve të Republikës të Maqedonisë së Veriut për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor, 2019